



15/06/2022

Elbasan – Parandalohet përshkallëzimi i konfliktit, Policia i gjen 52-vjeçarit të arrestuar, armën e zjarrit të fshehur në murin përreth shtëpisë

Ushtri dhunë psikologjike dhe kanosi bashkëshorten dhe djalin e tij, Policia vuri në pranga 52-vjeçarin.

Gjatë informacionit të marrë nga hetimet e kryera, Policia i gjen të fshehur, në murin përreth shtëpisë, një armë zjarri pushkë, me të cilën dyshohet se ka kanosur familjarët e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimin në Komisariatin e Policisë Elbasan, në kuadër të operacionit “Vullnetari”, si rezultat i të cilit u vu në pranga 52-vjeçari B. P., për veprën penale “Dhuna në familje”, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, kanë thelluar hetimet për këtë rast.

Si rezultat i hetimeve të thelluara dyshohej se shtetasi B. P. kishte armë të fshehur në banesë dhe se dhuna mund të përshkallëzohej pasi ky shtetas të mbaronte vuajtjen e dënimit. Nisur nga këto dyshime, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll të imtësishëm për disa ditë, në banesën e shtetasit B. P.

Si rezultat i kontrolleve, shërbimet e Policisë bënë të mundur gjetjen dhe sekuestrimin e një arme zjarri pushkë, të cilën ky shtetas e kishte fshehur në murin përreth shtëpisë.

Materialet shtesë në ngarkim të këtij shtetas, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Shtetasi B. P. është aktualisht në institucionin e paraburgimit në Bradashesh, Elbasan.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Berat – Edukojmë fëmijët e shkollës fillore “Ylli i Mëngjesit”, me rregullat e qarkullimit rrugor

Korçë – Sekuestrohen pasuri që dyshohet se e kanë burimin nga aktiviteti kriminal ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)